

TREMA <‘> NË KODIN ALFABETIK TË AT GJERGJ. GUXETËS DHE NDONJË ÇËSHTJE QË LIDHET ME TË

I. *Qerthulli problematik dhe diskutimi përkatës*

Lëvrimi i shqipes me alfabet latin njihet në historiografinë e kulturës shqiptare si tradita më e hershme e shkrimit shqip, e cila, falë vendimeve të tubimit të parë albanologjik në hapësirën kompakte shqipfolëse (Manastir, nëntor 1908), gjeson prej më se një shekulli statusin e simboleve mbarëkombëtare shqiptare. Një kolorit gjithëshqiptar i përcjellin Alfabetit të Manastirit sidomos dy pikat (= tremë <‘>) si karaktere grafike që rrekemi sot e gjithë ditën – sigurisht jo pa lodi e mëdyshje – t'i vendosim në mënyrë korrekte për të sendërtuar grafikisht zanoren qendrore <ë> (= /ë/ = [ə]) të toskërishtes, e si të tillë edhe të shqipes standarde, apo të ashtuquajturën “e të pazanë” të gegënishtes. Janë pikërisht këto dy pika, që gjelliynë në gjuhën e shkruar me një denduri aq të lartë e në çdo pozicion, çka parakupton gjithherë përqendrim të plotë për të shkruar bukur e pastër. Çdo shqipshkrueshës është më se i ndërgjegjshëm përfaktin se sa shumë mund t'i kushtojë zvjerdhja sadopak e vëmendjes, kur synon të hedhë në letër një mendim shqip; dhe është paradoks i fatit, që bash në kushtet e sotme të teknikës kompjuterike, pak gjë e ka përmirësuar gjendjen në këtë pikë, apo – thënë ndryshe – në këto dy pika.

Po ta gjykojmë pozitivisht këtë rrrethanë, nuk bëjmë gjë tjetër veçse i mëshojmë fort faktit, e në bashkëlidhje me të edhe fatit, se përgjatë rrjedhës normale të një dite akademike duhet të sjellim shpesh ndër mend – jo rrallë edhe nëpër dhëmbë – emrin e arbëreshit zulmëmadh Jeronim De Rada për njérën ndër gjetjet e tij grafike, së cilës kongresistët e Manastirit nuk munguan atëbotë t'i bënин vend në kodin e ri alfabetik, duke përjetësuar kështu edhe botën italo-arbëreshe në matriksin e simboleve kombëtare të kulturës etnike gjithëshqiptare, shi duke huazuar prej kodit të tij alfabetik shkronjën zanore <ë> me ato dy pikat sipër.

Zhvillimet e fundit në filologjinë arbëreshe kanë bërë të mundur të qëmtohen në retrospektivë tëbanat kryesore, ku ka baritur dikur kjo grafi fatlume në viset arbëreshe, madje ndërkohë është vatrëzuar edhe gurra e saj zanafillëse (Mandalà 2006). Është fjala këtu për vepërzon e

mbetur në dorëshkrim qysh prej gjysmës së parë të shek. 18-të e me autor apostullin e arbëreshëve të Sicilisë, At Gjergj Guxetën (= Padre Giorgio Guzetta), një vepër kjo që përjetoi para një viti dritën e botimit (Guzzetta 2007), duke u bërë kështu pronë e një rrethi të gjerë lexuesish dhe specialistësh të fushës.

Objekt i këtij punimi të thukët është kreu i tretë i kësaj vepre me titull "La lingua degli Albanesi", në të cilin Guxeta pjesëmerr në debatin e rretheve intelektuale të kohës mbi natyrën dhe origjinën e shqipes, e në bashkëlidhje me to, nuk mungon të nxisë edhe një debat të ri intelektual me shqipshkruesit bashkëkohës lidhur me kodin alfabetik të shqipes së shkruar atëbotë si edhe mbi përmirësimet që mund dhe duheshin ndërmarrë në të.

II. Origjina e shqipes dhe veçoritë si gjuhë e lashtë e Ballkanit antik

Sa i përket qerthullit tematik mbi natyrën e shqipes dhe origjinën e saj, lejohem të përmend shkurt, mënyrën se si apostulli ynë përdor argumentin e mirëfilltë gjuhësor, duke syuar njëherësh mëvetësinë e kësaj gjuhe ndaj gjuhëve fqinjë si ilirishtja (= sllavishtja), turqishtja dhe greqishtja. Sipas tij:

"Së fundi, pér këtë gjuhë mbetet pér të hulumtuar, nëse është e vetë popullit shqiptar, apo është e varur dhe e përfuar nga ndonjë tjetër. Në të vërtetë shumë vetë e konsiderojnë atë greke; disa e përsiasin atë ilirike [= sllave – B. D.], të tjërë turke. Por në të vërtetë, pasi u bë një krahasim midis tingujve të këtyre gjuhëve, u zbulua se asnjëra prej këtyre dy gjuhëve nuk përpushton me gjuhën shqipe; po të merreshin [pér krahasim – B. D.] disa fjalë të greqishtes dhe të një ose dy gjuhëve të tjera, do të kuptohej, se cilat janë ato që falë bashkëjetesës së gjatë të shqiptarëve me ato popullsi fqinje kanë mundur të depërtojnë në gjuhën shqipe."¹

Në të njëtin përfundim arrin Guxeta edhe gjatë përqasjes së strukturës gramatikore të shqipes me latinishten, duke nxjerrë në pah ndër të tjera dallimet e thella gramatikore dhe fonetike ndërmjet këtyre dy gjuhëve, khs.:

"Do të them diçka të re, që do të ngjallë me lehtësi habinë e të gjithëve. Marin Barletti i Shkodrës, shqiptar me origjinë dhe gjuhë,

¹ Citati origjinal: „Di questa lingua infine resta da ricercare se sia propria della gente albana, o se sia dipendente e prodotta da un’altra. Infatti una moltitudine di persone la considera greca: alcuni la immaginano Illirica, altri Turca. Ma in effetti, dopo che fu fatta una comparazione tra i suoni di queste lingue tra loro, si è scoperto che nessuna di quelle due concorda con la lingua albanese; se si prendessero alcune voci dalla (lingua) greca e una o due dalle altre (lingue), (si comprenderebbe) quali (sono) quelle che la lunga familiarità degli Albanesi con quelle popolazioni confinanti introducesse nell’idioma albano.”

në Historinë e Skënderbeut mendon që ajo të jetë gjuha latine, kaluar nga italikët tek epirotët. Nga njëra anë shumë njësi latine, që rrjedhin prej latinëve e që gjelqjnë në gjuhën shqipe në sasi të mëdha, të paktën të bindin se nuk jemi larg së vërtetës, edhe pse jo të gjitha ruajnë kuptimin zanafillës të fjalëve latine, ndërsa të tjera zoterojnë një [kuptim – B. D.] dytësor, vetëm të përafërt në atë gjuhë. Megjithëse jo krejtësisht, fjalët anase tregojnë në mënyrë të mjaftueshme, se sa më shumë të janë përshtatur në këtë gjuhë [huazimet latine – B. D.], aq më shumë ndryshojnë ato nga gjegjëset [burimore – B. D.]; optimet, sikurse ai i emrave ashtu edhe i foljeve, janë aq të veçanta për këtë gjuhë, sa që nuk përqasen me asnje idiole tjetër. Veçanërisht në zgjedhimin e foljeve, për të cilat shqiptarët mjaftohen vetëm me përdorimin e mënyrës dëftore, me kohët e saj të së tashmes, së pakryerës dhe të aoristik, që është i ngjashëm me atë të grekëve, si edhe të urdhërores së tashme, duke përdorur parafrazime të shumta dhe të ndryshme për kohët dhe mënyrat e tjera, sipas mënyrës së barbarëve.”²

Gjithsesi Guxeta është më se i vetëdijshtëm që leksiku i shqipes ngërthen në vetvete një përbërëse të fuqishme latine, andaj nuk mungon të mëtojë – ndoshta me të drejtë – se shqipja moderne përfaqëson në vetvete një ngjizje të elementit latin me leksikun anas dhe strukturën gramatikore të shqipes së lashtë, të cilën ai – në përputhje me konceptin e tij mbi mjeshtin gjuhësor në Ballkanin antik – e njëson me maqedonishten e antikitetit. Kështu:

“Duke qenë situata e tillë, që një varietet shumë i madh fjalësh, qofshin ato latine, apo barbare, me të cilat është e pasur gjuha e sotme anase e shqiptarëve, ajo vijoi të kompozohej deri në një pikë të tillë, saqë ne mund të themi sot se ajo nuk është aspak latine, por një përzierje e latinishtes me maqedonishten antike.”³

² Citati origjinal: „Dirò qualcosa di nuovo, un paradosso, che desterà facilmente la meraviglia di tutti. Marino Barlezio di Scodra, albanese di nascita e di lingua, nella *Storia di Skanderbeg*³ pensa che quella sia la lingua latina, passata dagli Italiici agli Epiroti. Da una parte moltissime voci latine, derivate dai latini e di cui la lingua albanese abbonda in gran quantità, convincono almeno che non siamo lontani dal vero, sebbene non tutte conservino il significato originale delle parole latine, mentre alcune ne hanno uno secondario e approssimativamente affine a quella lingua. Anche se non del tutto, le voci barbare mostrano sufficientemente che quanto più sono proprie di questa lingua, (tanto più) sono del tutto diverse da quella latina; le flessioni sia dei nomi sia dei verbi sono così peculiari di questa lingua che non si adattano a nessun altro dialetto. Specialmente nella coniugazione dei verbi per i quali gli Albanesi si contentano del solo modo indicativo, e dei suoi tempi del presente, imperfetto e aoristo, che è simile a quello dei greci, e dell'imperativo presente, usando molte e varie circonlocuzioni per gli altri tempi e modi, alla maniera dei barbari.”

³ Citati origjinal: “Stando così le cose, una sì grande varietà di voci, sia latine sia barbare, di cui è ricca l'odierna lingua vernacola degli albanesi, si andò componendo a tal punto che noi

Më tej:

"Mendoj që kjo [përzierje – B. D.] të ketë ndodhur në këtë mënyrë: d.m.th., duke qenë se albanët e lashtë midis Epirit dhe Maqedonisë përdornin dy gjuhë, maqedonishten dhe latinishten, me kalimin e kohës këto dy gjuhë duhet të jenë përzier midis tyre në një mënyrë të tillë që më në fund latinishtja, duke qenë përhithur dhe përshtatur nga maqedonishtja, e cila ushtron te hegemoninë mbi të; nga shkrirja e të dyjave ato më në fund formuan një gjuhë të vetme, të përzier me njëra-tjetërën, të cilën e shohim sot të lulëzojë në gjithë Arbërinë, d.m.th. në Epir dhe Maqedoni. Duke qenë përcjellë, në bazë të këtyre interpretimeve, historia e origjinës latine të gjuhës primitive të shqiptarëve, nuk ka asnjeri që të mos shohë që ajo përforcohet mjaft mirë nga vetë gjuha amtare e shqiptarëve, për çka kemi marrë këtu zotimin për të ilustruar veçoritë e saj."⁴

Për një njohje dhe shqyrtim në detaj të tezës së vet mbi rolin e fondit latin në formëzimin e shqipes moderne bashkëkohore Guxeta sheh të udhës – me të drejtë – që të térheqë në debatin shkencor-intelektual edhe autoritetin e eruditëve latin(ist)ë të kohës. Sipas tij:

"Problemi më i vështirë për t'u kapërcyer, është të bindim eruditët latin(ist)ë për etimologjinë e fjalëve latine, që kemi thënë se gjenden në gjuhën shqipe. [...] dhe ndoshta jemi të parët që kemi nxitur vëmendjen për këtë çështje."⁵

diciamo che essa non è del tutto latina, ma un misto di latino e di macedonico antico.", duke vazhduar më tej: "Infatti pensiamo che le voci barbare del tipo *Pella*, dialetto, flessioni che abbiamo visto che si trovano in essa, siano tutte proprie dell'antica lingua macedonica dal momento che non sono uguali o simili a nessuna delle altre lingue sia Orientali sia Occidentali che io abbia conosciuto. E poiché lì le voci latine non seguono la lingua latina, ma il dialetto macedonico, più correttamente diremo che assolutamente (predomina) la lingua macedonica con una notevole mescolanza di voci latine."

4 Citati originali: "Penso che ciò sia avvenuto in questo modo: cioè, poiché gli antichi Albani fra l'Epiro e la Macedonia usavano due lingue, la macedonica e la latina, con il passare del tempo queste due lingue dovettero mescolarsi tra loro in modo tale che alla fine, essendo stata la latina come assorbita e adattata alla Makedonica che esercitava l'egemonia su di essa, essi infine dalla fusione delle due, formarono una sola lingua, mista dell'una e dell'altra, quale oggi la vediamo prosperare in tutta l'Albania, cioè l'Epiro, e la Macedonia. Essendo stata tramandata, sulla base di tutte queste interpretazioni, la storia dell'origine latina della primitiva lingua degli Albanesi, non c'è nessuno che non veda, che essa sia rafforzata abbastanza bene, dalla stessa lingua vernacola' degli Albanesi, per cui abbiamo qui assunto l'impegno di illustrarne le peculiarità."

5 Citati originali: "Il problema più difficile da superare è quello di convincere gli eruditi latini sulla etimologia delle voci latine, che abbiamo detto si trovano nella lingua albanese. Ci sarà mai qualcuno⁷ che crederà a quanto abbiamo capito ascoltando, dal momento che neppure noi abbiamo udito le parole latine, e forse per primi abbiamo destato l'attenzione su questa questione?"

Kjo paraqitje e thukët e përfundimeve të Guxetës lidhur me origjinën e shqipes bashkëkohore, veçoritë e strukturës së saj fonetike dhe gramatikore si edhe komponentët përbërës në fondin e saj leksikor na lejon tashmë të përcjellim me saktësi, qoftë edhe një pjesë të përmirësimeve që ndërmerr apostulli ynë në kodin alfabetik të shqipes letrare të kohës, i cili përfaqësohej atëbotë me të ashtuquajturin "Alfabet të Propagandës".

III. Trema <> si gjetje grafike dhe sfondi i saj historik-kulturor në veprën e Guxetës

Ndryshe nga "maqedonasit modernë", siç i emërtion ai lëvruesit e shkrimit shqip në arealin kulturor të Veriut katolik, të cilët, sipas tij: "duke ndjekur traditën e shkrimit galik [= francez – B. D.], i shkruajnë fjalët në mënyrë të ndryshme nga sa i shqiptojnë", Guxeta sheston përmirësime thelbësore në kodin grafik të shqipes me bazë alfabetin latin, i cili do të sendërtonte atëbotë një bashkëpërkim të plotë ndërmjet shqipes së shkruar dhe asaj të folur. Kështu:

"Si rrjedhim, janë për t'u lavdëruar maqedonasit modernë, që, të mësuar mirë në shkronjat latine në Kolegjin e Propaganda Fide-s, morën nismën të shkruajnë në këtë gjuhë libra shumë të devotshëm për t'u përdorur nga populli i tyre dhe për t'i botuar ata në kohën tonë me shkronjat tipografike (të njohura). Në tipin tonë të shkrimit disa përdorin shkronjat latine dhe, duke qenë se gjuha shqipe midis bashkëtingëlloreve shtie në përdorim tingujt e aspiruar grekë, [...] ata preferuan të shpiknin shkronja të reja në vend të atyre greke.

Prandaj duke lexuar këta libra më shqetëson jo pak fakti që ata, duke ndjekur përdorimin e shkrimit galik (= francez), i shkruajnë fjalët ndryshe nga mënyra se si i shqiptojnë. [...] Prandaj unë, që të mund të shkruaj në këtë gjuhë me më shumë kujdes dhe zhdërvjelltësi (sikurse do të veproj), do të përdor në të njëjtën mënyrë shkronjat latine dhe, kur këto do të mungojnë, nuk jam aq besëtytë sa të trembem për t'i plotësuar ato me shkronja greke dhe do të përpinqem t'ia përshtat shkrimin shqiptimit korrekt në gjithçka."⁶

⁶ Citati original: "Da lodare sono quindi i moderni Macedoni che, ben istruiti nelle lettere latine nel Collegio de Propaganda fide, presero l'iniziativa di scrivere in questo idioma piissimi libri ad uso della loro gente e di consegnarli ai nostri tempi nei caratteri tipografici (noti). Nel nuovo tipo di scrittura alcuni usano i caratteri latini, e poiché la lingua albanese tra le consonanti introduce le aspirate greche, dopo averle abbandonate, sarebbe strano che nel nuovo genere di scrittura di questa gente, trasformassero i caratteri non greci in lettere greche, ma preferirono inventare nuovi caratteri e sostituirli a quelli greci.

Perciò nel leggere questi libri mi irrita non poco il fatto che essi, seguendo l'uso della scrittura gallicana, scrivano le parole in modo come le pronunciano. [...] Perciò io, per potere scrivere in questa lingua con maggiore cura e scioltezza (nel modo in cui farò), userò allo stesso modo

Vendosja e raportit $1 \times 1 \times 1$ në bashkëlidhjen *grafemë ~ fon ~ fonemë* (= shkronjë ~ tingull ~ t. me funksion kuptimdallues), për të cilin tëharr Guxeta në vepërzen e tij, na kujton pikërisht platformën, ku zuri rrënje Alfabeti ynë i Manastirit e që jemi mësuar ta quajmë sot si mbështetje në parimin fonetik/fonologjik.

Zbatimin me rreptësi të këtij kriteri metodik e sendërton bindshëm, ndër të tjera, edhe përdorimi i tremës <‐> si mjet grafik që lejoi Guxeten të dallojë një tingull zanor që ishte sipas karakteristik vetëm për shqipen, sikurse mësojmë edhe në paragrafin që vijon:

“Të gjitha zanoret janë [të natyrës – B. D.] latine dhe është karakteristike për këtë gjuhë rrëthana që shpesh zanoret përftohen me hundë dhe mbyllje të gojës për të realizuar një tingull që është diku aty në mes, ndërmjet [e]-së dhe [i]-së, sikurse francezët duket të shqiptojnë <e>-në fundore, duke e rrëgjuar atë në zgavrën e gojës (duke e ndërrprerë emetimin e tingullit). Me vështirësi përsias që të jetë shqiptuar [si e tillë – B. D.] në kohën antike <η>-ja greke, të cilën tashmë disa priren ta shqiptojnë si [e] e të tjerë si [i]; unë do të shënjoj me dy pika ose me theks lakor zanoret e këtij tipi që duhen shqiptuar me hundë.”⁷

Një lexim sado i përciptë i pasazhit të mësipërm na orienton drejt izolimit të zanores së rrëgjuar *Schwa* (= [ə]) që sot jemi mësuar ta vendosim në qendër të trekëndëshit akustik të zanoreve të shqipes, por që Guxeta, si i pari në kohën e vet, e percepton si zanore sigurisht të rrëgjuar, por të përparme. Vëzhgimi i tij plotësues, që ky tingull zanor, të cilin ai preferon ta dallojë grafikisht ose me tremë, ose me një theks lakor mbi shkronjën zanore përkatëse, nuk e mëdysh aspak bindjen tonë, që këtu kemi të bëjmë pikërisht me zanoren e ashtuquajtur qendrore /ë/ (= [ə] = <ë>) të toskërishtes në përgjithësi, realizimi fonetik i së cilës sot e gjithë ditën ngérthen një spektër shumë më të gjerë së fonemat e tjera zanore të këtij dialekti. Gjithsesi Guxeta nuk është as i pari dhe as i fundit që i njeh nyjëtimit të zanores qendrore të Horës së Arbëreshëve të Sicilisë një timbër hundor. Mjafton të sjellim për këtë në analizë përshkrimin që i bëri realizimit të kësaj zanoreje rrëth një shekull e gjysmë më parë Lekë Matrënga (1492), të cilin Guxeta me sa

i caratteri latini e, quando questi mancheranno, [...] e cercherò di conformare la scrittura alla corretta pronuncia in tutto.”

7 “Tutte le vocali sono latine; ed è caratteristico di questa lingua il fatto che spesso le vocali sono emesse con il naso a bocca chiusa, per riprodurre un suono che è a metà tra <e> ed <i>, come i galli sembrano pronunciare la <e> finale interrompendola sulla bocca (fermando l’emissione del suono). Con difficoltà penso che sia pronunciato dagli antichi la <η> greca che alcuni ora tendono a pronunciare <e>, ed altri <i>; io segnerò con due puntini o con l’accento circonflesso le vocali di questo tipo che bisognerà pronunciare con il naso.”

duket nuk e ka njohur, dhe sipas të cilit kjo zanore nyjëtohet po "me hundë"⁸. Të njëjtat veçori fonetike i njeh kësaj zanoreje më shumë se dy shekuj më pas edhe A. Guxeta (= A. Guzzetta 1978 61), kur përshkruan sistemin fonetik të së folmes së Horës.⁹

Zgjidhja e këtij problemi – thënë ndryshe pseudo-problemi – rrëth hundorësisë së tingullit të rrëgjuar zanor në të folmen e Horës na lejon tani t'i drejtohem i një pyetjeje ndoshta më të vështirë që përcjell pasazhi i mësipërm, ku Guxeta përdor numrin shumës kur shkruan se "... është karakteristik për këtë gjuhë fakti që shpesh zanoret përftohen me hundë e mbyllje të gojës për të realizuar një tingull që është diku në mes, ndërmjet <e>-së dhe <i>-së." Kjo pyetje merr formë të plotë, kur lexojmë listën e një numri njësish leksikore me burim latin dhe roman, të cilat Guxeta ia bashkon si shtojcë kreut të tretë, për të dëshmuar ndër të tjera edhe ndikimin e fuqishëm të kësaj gjuhe në formëzimin e shqipes moderne. Në inventarin e kësaj liste feksin dy pikat që Guxeta i vendos jo vetëm mbi shkronjën zanore <e>, por (më rrallë) edhe mbi gjegjësen <a> dhe në një rast edhe mbi simotrën <u>¹⁰, khs.:

<i>Significationes propre</i>	<i>Nomina</i>	<i>Unde derivant</i>
Labra	Buzë	Basio, et basiendo
Braccio	Lorë	Lorum a tegumento
Vento	Eerë	Aer
Està	Veerë	Ver
Argento	Rghënt	Argentum
Anello	Unazë	Unio
...
Gamba	Kämbë	

8 "Secondariamente ho provisto a una gran difficoltà che hano i greci albanesi in proferire un certo sono, che quasi occorre in ogni ditione et per esser di tutto apieno informata Vostra Signoria Illustrissima saperà che l'Albanesi quasi a ogni parola hano un certo sono che si fa col naso, e pur non è ordinariamente vocale particolare cioè *A*, *o*, *e u*, ma alle volte solamente un sono che si fa, come ho detto, col naso. Onde ho fatto per segno quando occorre tal sono, o vocale proferita col naso, un a dittongo. Questo bene intenderanno con questa instruzione gl'Albanesi se bene sarra difficile agl'altri finche con la pratica impareranno la pronuntia." (Matranga 1592 – Drsh. 1, hyrje).

9 Çabej (1935 74 v.) nuk i njeh kësaj zanoreje një timbër hundor. Megjithatë e karakterizon nyjëtimin e saj si një një zanore me "i-Basis". Shih më hollësish për historikun e studimit Belluscio 2002 51 vv.

10 Përqasja e listës së fjalëve shqipe me njësitë burimore përkatëse për nga perspektiva e paraqitjes grafike lejon të vëndosen pak a shumë këto marrëdhënie distribucionale: grafitë shqipe <ä> dhe <ü> u përgjigjen në çdo rast grafive <a> përkatësisht <u> në njësitë leksikore të gjuhës dhënëse. Përndryshe grafia <ë> i përgjigjet ose grafisë <e> ose mungesës së një grafie zanore në gjuhën dhënëse.

Dolce	Ämblé	Ital: Amabile
Madre	Mämë, Äm	Mamma
...
Così	Küsctu	Ital. Questo

Përse kjo procedurë? Një përgjigje paraprake e qëmtojmë në vetë pasazhin në fjalë, ku Guxeta thekson se është fjala pér një tingull të vetëm që shqiptohet i rrëgjuar dhe me hundë, gjë që na nxit të deduktojmë si zgjidhje alternative mendimin se Guxeta është më se i ndërgjegjshëm pér atë dukuri që përfjetoi në kohë dhe hapësirë sistemi i zanoreve të shqipes, të cilin jemi mësuar ta quajmë shpesh si rrëgjim (dhe centralizim) të zanoreve. Këtë zgjidhje që e përsiasim paraprakisht si alternative e përforcon më tej një tjetër pasazh, ku Guxeta pëershruan fatin e huazimeve latine në shqipe, duke shkruar se:

“Gjithë vështirësia pér të kuptuar, duke dëgjuar, i detyrohet ose ashpërsisë së latinishtes primitive, ose, sidomos, shqiptimit jo-korrekt [të latinizmave – B. D.] prej këtij populli [= shqiptar – B. D.]. Sepse shqiptarët, veçanërisht në shqiptimin e fjalëve latine, i bjerrin thuajse të gjitha zanoret e pér rrjedhojë fjalët shqipe janë përgjithësisht njërrokëshe dhe, nëse ruajnë ndonjë prej tyre, ose e shqiptojnë me hundë, ose e shndërrojnë në një tingull tjetër; shpesh cungojnë edhe rrokje të tëra, sidomos ato fundoren; shurdhojnë disa nga bashkëtingëlloret duke i shndërruar ato në të tjera të ngashme ose anasjelltas.”¹¹

Zgjidhjen alternative paraprake të kësaj çështjeje tanë – pas leximit dhe interpretimit të mirëfilltë të këtij pasazhi të dytë (shih edhe shën. 10) – lejohemi ta quajmë bindëse, në rast se përsiasim edhe një kriter të dytë metodik, që mund dhe duhet të ketë orientuar Guxetën pér të ndërmarrë përmirësimet në kodin e atëhershëm alfabetik të shqipes dhe drejtshkrimin e saj. Është pikërisht parimi i ashtuquajtur historik apo etimologjik, që do t'i ndërgjegjësonte atëbotë pér gurrat e leksikut të shqipes bashkëkohore jo vetëm eruditët latin(ist)ë por çdokënd që do të shkruante dhe lexonte shqip. Khs.:

“Jo ndryshe nga gjuha italiane, galike, spanjolle, të prejardhura nga gjuha latine me variante të ngashme, me të cilat gjuha shqipe nganjëherë bashkëpërkon, aq sa të krijon përshtypjen se përban fjalë të tëra, e që mund të thuhej se janë marrë nga

¹¹ Citati original: “Tutta la difficoltà di intendere ascoltando deve essere attribuita sia alla rozzezza della primitiva lingua latina sia, particolarmente, alla scorretta pronuncia di questa gente. Perché gli albanesi, in particolare, nel pronunciare le parole latine, elidono tutte le vocali per cui le espressioni albane sono generalmente monosillabiche, e se mantengono qualcuna di esse (vocali) o la emettono con il naso o la trasformano in un altro suono; spesso troncano anche intere sillabe, specialmente quelle finali: tacciono alcune tra le consonanti trasformando altre in altre affini ad esse o invertendole.

italikët, nga galët, nga spanjollët. Si rrjedhim nuk do të ishte e vështirë të besohej që këta popuj, të ardhur dikur në Shqipëri, siç thamë, do të kenë lënë aty gjurmët e gjuhës së tyre.”¹²

IV. Facit

Kjo zgjidhje alternative që urojmë dhe shpresojmë. të përkojë në një mënyrë a një tjetër me vetë përsiatjet e dikurshme të apostullit albanolog si edhe me ndërmarrjet e tij konkrete për të përmirësuar kodin alfabetik dhe drejtshkrimin e shqipes së kohës, ndesh një rrethanë paralele në kohën tonë, ku vendosja korrekte e dy pikave mbi <ë> ndërthur – sa bindshëm aq edhe dhimbshëm – dy parime metodike deri diku kundërvënëse në paketën e rregullave drejtshkrimit të shqipes standarde: parimin fonetik/fonologjik me atë historik/etimologjik. A do të vazhdojmë edhe nesër kështu, duke vijuar këtë traditën e mirë shqiptare-arbëreshe, që trashëgojmë qysh prej kohës së Guxetës apo do ta “përmirësojmë” më tej këtë traditë?, ky qerthull problematic mund dhe duhet të ngërthehet në debatin bashkëkohor në vigjilje të 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit.

Bibliografi e përzgjedhur

- Altimari, Francesco: Il movimento culturale della Rilindja e il Collegio di S. Adriano nella prima metà del secolo XIX, nr. 11 i serisë “Quaderni di Zjarri” 11 [1984]. Cosenza
- Belluscio, Giovanni M. G.: Un primo esperimento per la definizione elettroacustica del vocalismo di *Hora e Arbëreshëvet* (PA), në: „Studi in onore di Antonino Guzzetta“ (bot. F. Di Miceli – M. Mandalà), Palermo 2002, f. 51-62
- Blanchus, Franciscus (= Frang Bardhi): *Dictionarum latino-epiroticum*, Romæ 1635
- Çabej, Eqrem: Italo-albanische Studien, Dissertation zur Erlangung des Doktorgrades an der Universität Wien (drsh. 145 f.)
- Demiraj, Bardhyl: Sprovë për një lexim kritik të materialit gjuhësor në veprën e Angelo Masci-t, në: „Studi in onore di Antonino Guzzetta“ (bot. F. di Miceli – M. Mandalà), Palermo 2002, S. 115-131
- Giorgio Guzzetta e le origini della filologia italo-albanese, në: “International Journal of Diachronic Linguistics and Linguistic

¹² Citati original: “Non diversamente dalla lingua italiana, gallica, spagnola, derivate dalla lingua latina con simili varianti, con le quali talvolta la lingua albanese concorda sicché dà l’impressione che contenga intere voci che si direbbero prese propriamente dagli italiani, dai galli, dagli spagnoli. Quindi non sarebbe difficile credere che queste genti, una volta introdotte in Albania, come dicevamo, vi abbiano lasciato i segni del proprio idioma.”

- Reconstruction” 4 [2007] 63-81.
- Aspekte të mendimit intelektual shqiptar në shek. e 18-të. Atë Gjergj Guxeta dhe vendi i tij në historinë e albanologjisë, në: “Hylli i Dritës” 3 [2007] 9-37
 - Guzzetta, Giorgio: L’osservanza del rito preso gli Albanesi d’Italia perché giovino a se stessi e a tutta la Chiesa (= titulli i originalit në dorëshkrim: De Albanesium Italiæ ritibus excolendis ut sibi totique S. Ecclesiae prosint), Palermo 2007.
 - Mandalà, Matteo (= Mateo Mandala): Luca Matranga, E Mbsuame e krështerë (a cura di Matteo Mandalà), në serinë: “Albanica”, nr. 21, Caltanissetta 2004
 - Vepra e pabotuar e At Gjergj Guxetës dhe fillimet e albanologjisë në shek. XVIII, në: “Studime Filologjike” 1-2 [2006] 11-41
 - Masci, Angelo: Discorso sull’origine, costumi, e stato attuale della nazione albanese, Napoli 1807.
 - Petrotta, Gaetano: Studi di storia della letteratura albanese. Popolo lingua e letteratura albanese, Palermo 1931.

SUMMARY

The question of the grapheme <ë> is one of the major problems of the still-progressing standardisation of Albanian. The paper takes in consideration essential historic aspects of how sound /schwa/ was traditionally written in Albanian. Special attention is paid to the role Fr Gjergj Guxeta played in the crystallization of the rule of this neutral sound.

This survey is closely tied to the conclusions of the Congress of Manastir as well as to the development of written Albanian in the current computer epoch.